



**HAL**  
open science

## Kërkimet arkeologjike shqiptare-franceze në Dyrrachium.Rezultatet e fushatës 2022

Catherine Abadie-Reynal, Kristi Anastasi, Gilles Brocard, Jean-Philippe Goiran, Arnaud Lefebvre, Eduard Shehi, Brikena Shkodra, Klodian Velo

► **To cite this version:**

Catherine Abadie-Reynal, Kristi Anastasi, Gilles Brocard, Jean-Philippe Goiran, Arnaud Lefebvre, et al.. Kërkimet arkeologjike shqiptare-franceze në Dyrrachium.Rezultatet e fushatës 2022. Candavia : Artikuj dhe raporte të Antikitetit të të Vonë dhe Mesjetës, 2024, 10. hal-04741880

**HAL Id: hal-04741880**

**<https://hal.science/hal-04741880v1>**

Submitted on 17 Oct 2024

**HAL** is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.

Catherine Abadie-Reynal<sup>1</sup>, Kristi Anastasi<sup>2</sup>, Gilles Brocard<sup>3</sup>, Jean-Philippe Goiran<sup>4</sup>, Arnaud Lefebvre<sup>5</sup>, Eduard Shehi<sup>6</sup>, Brikena Shkodra<sup>7</sup>, Klodian Velo<sup>8</sup>

## Kërkimet arkeologjike shqiptare-franceze në Dyrrachium

### Rezultatet e fushatës 2022<sup>9</sup>

Fushata e vitit 2022 synonte të vazhdonte kërkimet e realizuara në vitet 2018<sup>10</sup> dhe 2019<sup>11</sup>, veçanërisht në Forumin rrethor, me qëllim sqarimin e çështjeve të ngritura nga kërkimet e mëparshme. Në të njëjtën kohë, ne shfrytëzuam ndërprerjen e punës përgjatë viteve 2020 dhe 2021, pasojë e krizës shëndetësore të shkaktuar nga Covid-19, për të rinisur reflektimin mbi organizimin e vendbanimit duke marrë në konsideratë studimin e dinamikave mjedisore aktuale dhe të kaluara, të cilat kanë ndikuar në evolucionin urban të Dyrrahut. Prandaj ne vlerësuam të nevojshme përthithjen e të dhënave të reja për të kuptuar evolucionin kohor dhe hapësinor të lagunës (në verilindje të qytetit të sotëm), në lidhje me evolucionin urban të zonës. Zhvillimi i qasjes gjeoarkeologjike sjell plotësime thelbësore për të kuptuarit e këtyre proceseve, të cilat në fund do të lejojnë, siç është bërë edhe në vendbanime të tjera, në rindërtime paleogjeografike duke dhënë mundësinë për të krahasuar evolucionin e peizazhit dhe evolucionin e strukturës urbane. Pra, për ne, këtë vit, bëhej fjalë për të ndërthurur qasjen arkeologjike me atë paleomjedisore. Studimi i përbashkët duhet të bëjë të mundur të përcaktohet nëse kufizimet mjedisore ndikuan në mënyrë vendimtare në zhvillimin e qytetit që nga themelimi, si u përshtat qyteti me to, si dhe roli që luajti porti në zhvillimin e qytetit.

Aktivitetet në terren u zhvilluan nga data 27 maj deri më 8 korrik me një mbështetje financiare<sup>12</sup> e cila na mundësoi të punonim për gjashtë javë dhe të kryenim aktivitete të ndryshme, rezultatet e të cilave ofrojnë elementë të rinj për reflektim mbi historinë e qytetit dhe të evolucionit të tij.

---

<sup>1</sup> Profesoreshë emeritus, Université Lumière-Lyon 2, UMR 5189-HiSoMA. Bashkëdrejtuese e projektit.

<sup>2</sup> Doktorant, Université Lumière-Lyon 2, UMR 5189-HiSoMA.

<sup>3</sup> Kërkues i Asociuar, HDR, UMR 5189-HiSoMA.

<sup>4</sup> Kërkues, UMR 5133-Archéorient.

<sup>5</sup> INRAP-GEN, Kërkues i Asociuar UMR 7268-ADES.

<sup>6</sup> Profesor i Asociuar, Instituti Arkeologjik Tiranë. Bashkëdrejtues i projektit.

<sup>7</sup> Profesoreshë e Asociuar, Instituti Arkeologjik Tiranë.

<sup>8</sup> Doktorant, Instituti Arkeologjik Tiranë.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 165, datë 17.05.2022, i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

<sup>10</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2018a, f. 321-324.

<sup>11</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 335-404.

<sup>12</sup> Falënderojmë UMR 5189-HiSoMA, Institutin Arkeologjik Tiranë, Institutin e Arkeologjisë Detare (SHBA) dhe Fondacionin Gerda Henkel (Gjermani) për financimin që na kanë ofruar.

## GËRMIMET NË FORUMIN RRETHOR/MACELLUM (KANTIERET 4700-4800)

Objektivi kryesor ishte vazhdimi i studimit të habitatit të pasur romak që shtrihet nën Forum, por edhe qartësimi i kontekstit të zbulimit të një materiali shumë të veçantë të gjetur në vitin 2019, interpretimi i të cilit paraqet vështirësi<sup>13</sup>. Ky kantier u vendos në veri të atij 4600 të vitit 2019 (Fig. 1), dhe në veri të kanalit më të vonë të kullimit të ujit nga macellumi (C 4602). Një pozicionim i tillë kishte përparësinë që lejonte zgjerimin e gërmimit në lindje, në hyrje të forumit, pa u ndikuar nga prania e tabernave të vona, ndërtimi i të cilave ka krijuar gropa të thella duke dëmtuar nivelet më të hershme kulturore. Për arsye të ndryshme nuk u bë e mundur që këtë vit të zbrisnim nën nivelet romake, të cilat qartësisht pasojnë nivelet helenistike të banimit, e ndoshta edhe më të hershme, si kanë dëshmuar gërmimet e vitit 2019<sup>14</sup>. Megjithatë, ky gërmim ka bërë të mundur qartësimin e rezultateve të gërmimeve të mëparshme.

### *Nivelet romake*

Siç është dëshmuar tashmë në vitet e mëparshme, dy banesa pasuan njëra-tjetrën në periudhën romake. Më e hershmja, e ndërtuar mbi një mbushje dhe e shkatërruar nga një zjarr i furishëm, karakterizohet, si është dëshmuar edhe në gërmimet e mëparshme, më shumë nga kultura materiale e pasur sesa nga arkitektura e saj, e cila në masë të madhe nuk kuptohet. Në vitin 2019, ne kishim arritur këto nivele vetëm në një sipërfaqe të vogël, në skajin verior të gërmimeve, përballë kanalit C 4602. Asnjë mur që përkonte me këtë fazë nuk ishte zbuluar, përveçse një kanal të gërmuar me orientim veri-jug (US 4638 bis)<sup>15</sup>, që i përkiste procesit të grabitjes së materialit të një muri të fazës së parë romake. Vetëm një mur ende në vend, që mund t'i atribuohet kësaj faze, u gjet këtë vit në kantierin lindor. Bëhet fjalë për murin MR 48106 që shënon kufirin e gërmimit të këtyre strukturave për nga lindja. Nga ana tjetër, hendeuku i grabitjes së materialit 4638 bis shtrihet në veri, përmes kuadratit të gërmuar në vitin 2022 (US 4743). Muri prej guri duhet të ketë qenë rreth 0,40 m i gjerë dhe afërsisht paralel me MR 48106. Duket se shfaqej një dhomë e kufizuar në drejtim të veriut dhe lindjes me hendeqet e grabitjes së materialit US 4745 dhe US 4746 (Fig. 1); në krahun lindor ndoshta kishte një hyrje të gjerë drejt një kthine të madhe, aty ku ndërpritej hendeuku 4745.

Fig. 1: planimetria e sondazhit 4700, nën macellum (RAFAD).

Kjo hapësirë e përkufizuar në këtë formë do të ishte afërsisht 1,75 m e gjerë, për një gjatësi prej të paktën 2,50 m. Në të dyja anët e US 4743, gjendej dyshemeja SL 4744, në kuotën 3,25/3,30

<sup>13</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 342-344.

<sup>14</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 336-339.

<sup>15</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 345.

mbi nivelin e detit, e shtruar nga tulla të vogla katrore (0,18x0,18 m), të ruajtura mirë veçanërisht në pjesën veriore të gjurmimit, nën fragmentet e tavanit të shembur (Fig. 2). Gjurmimet e vitit 2022 provuan gjithashtu ekzistencën e përmendur tashmë të një kati të sipërm në këtë banesë<sup>16</sup>. Midis blloqeve të shembur mbi dyshemën SL 4744, një fragment betoni ruan gjurmën e një pllake të madhe, të ngjashme me ato që kanë rënë mbi të njëjtën dysheme dhe që duhet t'i përkasin nivelit të ecjes në katin e sipërm. Mbi to gjendej një pllakë gëlqerori, gjithashtu e shembur pak më vonë, e ndarë nga fragmenti i tavanit me një shtresë të vogël dheu. Kjo pllakë mund të jetë një prag midis dy kthinave në katin e sipërm (Fig. 2). Në nivelin më të lartë të zjarrit që shënon shkatërrimin e kësaj shtëpie (US 4735), u zbuluan shumë fragmente pikturë murale në një kuotë absolute prej 3,70 m, që tregojnë se muret e katit të sipërm ishin të zbukuruara, dëshmuar tashmë edhe në motivet floreale të gjetura në vitin 2019<sup>17</sup>. Së fundmi, në nivelin ku ndodheshin fragmentet e afreskut, në një kuotë prej rreth 3,33 m, ruheshin gjurmët e shumë dërrasave të karbonizuara, si në përfundim ashtu edhe në lindje të sondazhit: shumica e tyre kishin një gjerësi rreth 0,10 m dhe dukej se ishin të vendosura pingul përkundrejt trarëve më të trashë mbajtës (Fig. 3). Mendojmë se bëhet fjalë për strukturën e një tavani, duke përfshirë trarët që mbanin dërrasat e dyshemesë së katit të sipërm<sup>18</sup>.

Fig. 2: dyshemeja SL 4744 dhe elementet e katit të sipërm, të parë nga veriu (RAFAD).

Fig. 3: elemente strukturore në shtresën e shkatërrimit të njësisë 4740, parë nga perëndimi (RAFAD).

Nuk kemi pasur ende kohë për të studiuar sistematikisht materialin e ofruar nga këto nivele. Megjithatë, ai tashmë shfaqet i mjaftueshëm dhe veçanërisht interesant, si për interpretimin e funksionimit ashtu edhe për kronologjinë e kësaj banese. Materiali modest që vjen ndoshta nga kati i sipërm (US 4735 dhe US 4737), përmban shumë enë qeramike, të formave të ndryshme, të cilat do të sugjeronin se ishte ambienti i banimit. Nga ana tjetër, pjesa e poshtme e shtresës së shkatërrimit (US 4739 dhe US 4740) e cila duket se përkon me gjetjet në katin përdhes, veçanërisht në hapësirën e vogël qendrore, në lindje të US 4743, përmban më pak kulturë materiale. Nga ana tjetër bëhet fjalë për një material shumë të veçantë, i cili shfaqet si vazhdim i gjetjeve të vitit 2019 të realizuara në jug të kanalit të vonë<sup>19</sup>. Gjurmimet e vitit 2022 bënë të mundur qartësimin e kontekstit dhe kuptimit të këtyre zbulimeve. Saktësisht në të njëjtin

<sup>16</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 341-342.

<sup>17</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 344.

<sup>18</sup> CLEMENT *et alii*. 2019, fig. 5.

<sup>19</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 342-344.

nivel, në të njëjtën hapësirë qendrore që vazhdonte në të dyja anët e kanalit C 4602, ne zbuluam këtë vit një figurinë të vogël bronzi 0,09 m të lartë, që përfaqëson personazhin mitologjik Lare (Fig. 4), dëshmi e qartë se këtu duhej të gjendej një lararium (ose gjetjet vijnë nga një lararium). Origjinë të njëjtë ka edhe statujëza e një djaloshi, e gjetur në vitin 2019, prandaj mund të interpretohet me më shumë gjasa si një statujëz e Harpokratit, edhe nëse nuk mbart atributet e zakonshme të kësaj hyjnie. Përveç kësaj, figura e perëndisë Lare shoqërohej me një enë bronzi, e gjetur e shtypur në dyshtemenë e dhomës, si dhe enë qeramike të zgjedhura me kujdes për formën e tyre, e kundërta e asaj që mund të vërehet në materialin e ardhur nga kati i sipërm. Në njësinë 4739 janë zbuluar disa fragmente brokesh si dhe katër ekzemplarë të grupuar, të gjitha të ndryshme, por të plota, të vazove të tipit “*urnette a collarino*”. Njëra prej tyre, e cila ka paretet shumë të holla, me origjinë itallike, mund të datohet në fund të shek. I m.Kr. ose fillimi i shek. II m.Kr. Në të njëjtën shtresë u zbulua një enë qelqi që kishte në fundin e saj një mbishkrim të modeluar me kallëp (Fig. 5) C]SALVI/GR]ATI. Bëhet fjalë për një shishe të modeluar në punishten e *C. Salvius Gratus*, që ndodhej ndoshta në luginën e lumit Po ose në zonën e *Akuilesë*<sup>20</sup>, datuar në fillimin e shek. II m.Kr. Ky material mbështet hamendësimin sipas të cilit kemi të bëjmë me një lararium, ose me materialin që i përket një larariumi, dhe përmbante (duke mos harruar se nuk mundëm të gërmonim nën kanalën C 4602) një statujë të Harpokratit dhe një figurinë të perëndisë Lare. Këto objekte gjendeshin në katin përdhes, në një dhomë të vogël, e cila mund të ishte ose një faltore shtëpiake siç njihet nga raste të tjera<sup>21</sup>, ose një depo ku ruheshin këto objekte me vlerë. Nga ana tjetër, mund të saktësohet kronologjia e kësaj banese, me *terminus post quem* të shkatërrimit fillimin e shek. II m.Kr. dhe një datim më të mundshëm në gjysmën e parë të shek. II m.Kr., përse kohë mbetemi në pritje të leximit të monedhave.

Fig. 4: figurinë bronzi që përfaqëson perëndeshën Lare, në momentin e zbulimit të saj (RAFAD).

Fig. 5: markë e punishtes së qelqbërësit *C. Salvius Gratus* (RAFAD).

Më pas, kjo banesë u mbulua nga një shtresë e trashë argjile ngjyrë bezhë në jeshile (US 4734) që ishte vënë re edhe më parë<sup>22</sup>, përpara se struktura të reja të ngriheshin këtu. Këto nivele janë gjithashtu në vazhdimësi me gërmimet e vitit 2019<sup>23</sup>. Në lindje të gërmimit u zbulua një

<sup>20</sup> FOY 2015, 363-364, fig. 10, nr. 59-60.

<sup>21</sup> Shiko si shembull LAFORGE 2009; FUCHS 2016, f. 106-107.

<sup>22</sup> ABADIE-REYNAL *et alii.* 2019, f. 345.

<sup>23</sup> ABADIE-REYNAL *et alii.* 2019, f. 345-346.

mur (MR 4724) me gjerësi 0,80 m. Ai mund të jetë fare mirë muri rrethues lindor i kësaj ndërtese. Ishte ndërtuar me gurë të përmasave të ndryshme, por përgjithësisht mjaft të mëdha, të lidhur me një llaç të bollshëm, duke përfshirë shumë guralecë të vegjël ngjyrë gri (Fig. 1; Fig. 6). Kishte dy faqe anësore dhe mbushje të brendshme me gurë më të vegjël. Në fakt, ky mur ka përjetuar ndoshta dy faza të njëpasnjëshme: themelet, 0,30 m të larta, pasohen nga ndërtimi i parë i murit, paksa më i ngushtë se themeli, me disa fragmente tjegullash në lartësi, të cilat ruheshin pjesërisht, deri në një lartësi prej rreth 0,20 m. Më pas është ripërdorur dhe ka përjetuar një fazë të dytë, e karakterizuar nga prania e gurëve më të mëdhenj, të paprerë<sup>24</sup>. Në jug të kanalit C 4602, një mur me orientim lindje-perëndim u zbulua në vitin 2019 (MR 4628) dhe iu atribuua kësaj faze. Përveç këtyre dy mureve, hendeqet e grabitjes së materialit që kanë pasuar shkatërrimin e kësaj shtëpie, siç tregohet nga stratigrafia, na lejojnë të hamendësojmë se muret ndarëse janë ndërtuar duke ripërdorur muret e shtëpisë së mëparshme, siç ishte bërë edhe në pjesën jugore<sup>25</sup>. Prandaj mund të hamendësojmë praninë e një muri të madh veri-jug të përfaqësuar nga hendeuku i grabitjes US 4743 dhe një cep i kthinës në skajin verilindor të gjermimit. Ndërtesa do të paraqiste kështu të paktën tre dhoma të ndryshme, të ngushta dhe të zgjatura për të paktën dy hapësirat më lindore. Përtej, në veri, asnjë element arkitektonik nuk mund të specifikohet duke qenë se një gropë e madhe (US 4703), që daton nga fundi i shek. XX kishte shkatërruar të gjitha nivelet arkeologjike. Megjithatë, në fund të kësaj grope, një dysHEME e bërë me guralecë të vegjël dhe copa tjegullash (US 4736) (Fig. 1), e vendosur në kuotën 4,35 m dhe e ruajtur mbi 1,30 x 1 m, duket se lidhet me këtë fazë, megjithëse çdo lidhje stratigrafike ishte shkëputur nga gjermimet moderne. Dhoma në jug të kanalit US 4746 duket se kishte një dysHEME me pllaka qeramike të ruajtura dobët (SL 4730), e cila qëndron në një thellësi mesatare prej 4,08 m. Megjithëse është e pranishme në qendër të dhomës dhe duket mjaft qartë në prerje, nga ana tjetër, pllakat janë shumë të thërrmueshme dhe dysHEMEJA është prerë në vende të ndryshme, veçanërisht në lindje gjatë ndërtimit të podiumit rrethor, dhe në perëndim nga gjermime të thella. Kjo situatë, e cila është e vështirë për t'u shpjeguar, mund të ketë ardhur si pasojë e ripërdorimit të murit MR 4724. Mbi këtë dysHEME kemi hasur një shtresë rrëtimi të dendur dhe të trashë prej 0,40-0,50 m (US 4725), e përbërë nga tulla të papjekura, të shpërbëra. Këto na tregojnë se një pjesë e lartësisë së mureve ishte prej qerpiçi. Më sipër, një shtresë e hollë, e djegur (US 4720), mund të përkojë me kornizën e tavanit të shembur. Prej saj janë gjetur mbetje të djegura trarësh si dhe shumë gozhdë. Më lart gjendej një shtresë tjegullash që i përkasin çatisë së shtëpisë (US 4725 dhe 4728), në një kuotë midis 4,52 dhe 4,80 m. Në

---

<sup>24</sup> Shiko në vazhdim, f. 00.

<sup>25</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2018a, f. 323.

shtresat e shkatërrimit dhe rrënimimit u zbulua shumë material, veçanërisht monedha të palexuara dhe disa enë të plota, të thyera në dysHEME, duke përfshirë një amforë kreteze me fund të rrumbullakët të tipit AC1c, që me shumë gjasa që daton, më së shumti në fundin e shekullit të III<sup>e</sup><sup>26</sup>. Ndër fragmentet e shumta të qeramikës më i voni duket se i takon një ene gatimi afrikane e formës Hayes 197 (fundi i shek. II-IV). Prandaj, kjo ndërtesë duhet të jetë shkatërruar nga zjarri në fund të shek. III ose në fillimin e shek. IV m.Kr. Grabitjet e shumta të materialit, të materializuara nga hendeqet US 4743, 4745 dhe 4746, të cilat gjenden kudo në gjermimin e vitit 2022, janë më të vona se shkatërrimi, por me dallim të shkurtër kohor, pasi materiali i gjetur në to vështirë se mund të dallohet nga ai që lidhet me funksionimin ose shkatërrimin e ndërtesës. Nga ana tjetër, natyra e materialit të zbuluar, i përbërë kryesisht nga enë të formave të ndryshme (enë gatimi, amfora, broke, qeramikë tavoline), tregon se ndërtesa ka pasur veprimtari të ndryshme shtëpiake.

Fig. 6: muri MR 4724, i parë nga lindja (RAFAD).

### *Nivelet protobizantine*

Më pas ka ndodhur një aktivitet i madh nivelues, duke dëshmuar për një shkëputje tërësore në përdorimin e territorit nga periudhat më të hershme. Të gjitha rrënojat e ndërtesës së shek. III m.Kr. mbulohen nga një mbushje (US 4716) relativisht e trashë (kuota midis 4,80 dhe 4,97 m), e cila përmbante shumë fragmente të vogla llaçi, por shumë pak qeramike. Ndërtimi i fazës së parë<sup>27</sup> të forumit duket se është mbështetur në këtë mbushje, që i përgjigjet fillimit të themeleve të murit të podiumit. Këtë vit u nxorrën në dritë disa elementë që bëjnë të mundur saktësime të kësaj faze të parë, përveç murit rrethor të kolonadës, i cili ishte identifikuar tashmë në vitin 2019. Kështu, gjermimet e vitit 2022, para së gjithash bënë të mundur njohjen e sistemit të kullimit të ujërave për këtë fazë të parë: bëhet fjalë për një tubacion të gjatë, të krijuar me tuba qeramike (C 4708), i cili harkohej rreth murit të kolonadës (Fig. 1; Fig. 7). I ruajtur shumë mirë, ai u zbulua në një gjatësi prej afro 7 m, duke vazhduar përtej kufijve të gjermimit. Kanali qëndron drejtpërdrejt në mbushjen US 4716 dhe ishte ndërprerë nga kanali i vonë C 4602. Ky zbulim na lejon të kuptojmë më mirë një fragment kanali me tuba qeramike (C 4614) të zbuluar në vitin 2019, por të shkëputur nga gjermimet e mëparshme nga çdo marrëdhënie stratigrafike (Fig. 1). Bëhet fjalë për një kanal paralel me C 4708, por në gjysmën jugore të forumit. Këto gjetje dëshmojnë se kishte një sistem kullimi uji që kalonte përmes hyrjes lindore

<sup>26</sup> MARANGOU-LERAT 1996, f. 73, 76.

<sup>27</sup> ABADIE-REYNAL *et alii.* 2019, f. 346-347.

të forumit. Nga ana tjetër, menjëherë mbi C 4708, ne zbuluam një pllakë të madhe *in situ*, të zhvendosur shumë pak gjatë grabitjes së pllakave fqinje (Fig. 7). E vendosur në një kuotë prej 5,27 m, duket se është dëshmia e vetmë mbulesës (SL 4707) në hapësirën jashtë murit të podiumit, dhe korrespondon në mënyrë të përkryer me kryqëzimin midis themeleve dhe fazës së parë të murit të kolonadës. Së fundi, faza e dytë e murit MR 4724 (Fig. 6) e përbërë nga gurë të mëdhenj, të ngjashëm me ato që i përkasin të njëjtës fazë të murit të podiumit (MR 4675)<sup>28</sup> ruhej vetëm në dy rreshta. Ky ripërdorim i murit, pas shkatërrimit të ndërtesës së shek. III, ndoshta mund të lidhet me këtë fazë të parë të forumit pa qenë në gjendje të specifikojë funksionin e saktë të tij: muri i jashtëm i kompleksit, forma e saktë e të cilit mbetet hipotetike (e drejtë ose pak e rrumbullakosur ?); apo muri mbajtës i mbushjes së përgatitjes së ndërtimit? Së fundi, këto gjurmë sollën material të ri duke bërë të mundur përcaktimin e datimit të fazës së parë të forumit: në shtresën (US 4709) ku mbshtetej dysHEMEJA SL 4707 dhe në të cilën ishte futur kanali C 4708, u zbulua qeramikë në sasi të konsiderueshme. Fragmentet e sigillatës afrikane, me format Hayes 61B (4709.5) ose Hayes 67 (4709.3) me zbukurim (versionet e të cilave mbetet të detajohen), për momentin na tregojnë se ndërtimi i kompleksit daton në gjysmën e parë të shek. V m.Kr.

Fig. 7: strukturat kryesore të vonshme, parë nga jugperëndimi (RAFAD).

### ***Nivelet mesjetare***

Në lindje të kantierit 4700, gjurmë 4800 zbuloi veçanërisht nivele mesjetare mbi rrënojat e forumit. Mund të vërehej një nivel banimi 4826 (Fig. 8), që mbështetej në mbushje të butë, duke përfshirë materiale të bollshme (fragmente tullash, tjegullash, kockash kafshësh, qeramikë, gurë). Ky nivel përfshin edhe një vatër të vogël (4825) e cila ishte pjesë e kontekstit, që duket se ishte ndërtuar me nxitim.

Fig. 8: njësiti 48025 dhe 48026 (RAFAD).

Njësia e sipërme (4801) e cila ishte në një kuotë absolute prej 6,20 m përfaqëson nivelin e fundit që i është nënshtruar ndërhyrjeve moderne. Ajo përmbante mbetjet e një depozite të përbërë nga materiale ndërtimi shumë të fragmentuara, të përziara me rrënoja, pak qeramikë dhe pak kocka. Kjo depozitë duket se ka shërbyer si nivel ecjeje në kohën kur këtu u krijua një parcelë funerare. Vendndodhja e 4801 është shumë e rëndësishme: kjo mbushje mbulonte gjurmët e hyrjes së forumit, pas prishjes së tij. Datimi i tij mund të sigurojë një *terminus ante quem* për shkatërrimin e murit 4804 si dhe një *terminus post quem* për parcelën funerare.

---

<sup>28</sup> ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019, f. 356, fig. 14.



Parcela funerare (Fig. 9) dha gjashtë skelete dhe një varrim dytësor. Mbetjet tregojnë se ishin varre me gropë të thjeshtë, duke mos paraqitur asnjë element që mund t'i përkiste arkitekturës së varreve. Të gjithë ishin të orientuar nga lindja.

Fig. 9: pamje e përgjithshme e varreve, parë nga perëndimi (RAFAD).

### GËRMIMET PRAPA KISHËS SË SHËN LUÇISË (KANTIERI 8000)

Duke qenë se hapësira për kryerjen e sondazheve arkeologjike vazhdon të pakësohet në Durrës, u arrit të dakordësohej të kryheshin gërmime në pjesën jugore të qytetit, që është dhe nga me të dendurat në ndërtime dhe për rrjedhojë nga më pak të eksploruara, pikërisht pas kishës katolike të Shën Luçisë. Kjo zonë gjendet në kryqëzimin e rrugëve “Don Nikoll Kaçorri” dhe “Pal Engjëlli”, 70 m në lindje të bulevardit “Epidamn”. Ndodhet në zemër të bllokut të ndërtesave, midis presbiterit dhe korit të kishës (Fig. 10). Zgjedhja e kësaj hapësire u diktua edhe nga afërsia e supozuar e kësaj parcele me vendndodhjen e mundshme të vijës bregdetare antike. Në mënyrë të ngjashme, një gërmim i kryer në vitin 2001, në një ngastër të vendosur menjëherë në veri zbuloi atë që konsiderohej se ishte një pjesë e një rruge romake. Qëllimi i këtij gërmimi ishte të njihnim aktivitetet në këtë sektor bregdetar dhe si rrjedhim të kishim elemente të rinj mbi evoluimin e mundshëm të kësaj pjese të qytetit.

Fig. 10: vendndodhja e gërmimit pas kishës së Shën Luçisë (RAFAD).

Vendndodhja e sondazhit duhej të merrte parasysh kufizime të ndryshme sigurie, të lidhura me praninë e ndërtesave rrotull, si dhe mbetjet e ndërtimit ende ekzistues (themeli, pllaka betoni, depozitimi i rrënojave). Rilevimi i planifikuar fillimisht (10 x10 m) u reduktua në 10 m në gjatësi me gjerësi 8 m në perëndim dhe 6 m në lindje (Fig. 11-12).

Fig. 11: pamje e përgjithshme e gërmimit të marrë me dron (G. Emiri).

Fig. 12: plani i përgjithshëm i gërmimit (RAFAD).

### *Periudha romake*

Tre njësi janë përfaqësuese të kësaj periudhe. Ato u zbuluan rreth 3,20 m nën nivelin aktual të ecjes dhe u ndoqën në një thellësi prej rreth 1 m përpara se rritja e nivelit të ujit të na pengonte të vazhdonim gërmimin. Është vërejtur vetëm një fazë ndërtimore. Muri 8077 u zbulua pranë këndit juglindor të kuadratit (Fig. 13). Ai ndiqte një orientim jugperëndim-verilindje dhe kishte gjatësi 0,40 m, gjerësi 0,60 m dhe lartësi 0,40 m. Kryqëzohej në veri nga prerja mesjetare 8068. Ruheshin tre breza tullash të lidhura me llaç. Hendeku i themelit (8076)

ishite i mbushur me argjilë sterile në ngjyrë kafe (8091), rreth 10 cm i gjerë. Nivelet më të poshtme nuk ishte e mundur të vëzhgoheshin.

Fig. 13: pamje nga lartësia e murit 8077 (RAFAD).

### ***Periudha e antikitetit të vonë***

Katërbëdhjetë njësi i takonin kësaj periudhe. Ato zhvillohen midis 2,20 m dhe 3,20 m thellësi. Analiza e tyre bëri të mundur përcaktimin e 5 fazave të funksionimit (AT 1-AT 5). Vazhdimi i ndërtimeve gjatë fazave AT 2, 3 dhe 4 ishte i vështirë për t'u kuptuar dhe disa interpretime mund të rishikoheshin më vonë në varësi të zbulimeve të reja.

#### **Faza AT 1**

Përfaqësohet nga dy shtresa (8078 dhe 8079) të cilat gjenden në thellësi, në të dyja anët e murit 8066. Vëzhgimet ishin të kufizuara për shkak të thellësisë dhe afërsisë me nivelin e ujit nëntokësor. Të dyja përbëheshin nga rërë argjilore ngjyrë kafe, që përmbante fragmente tullash dhe llaçi. Mendojmë se duhej t'i takonin një konteksti të vetëm, të prerë përgjatë ndërtimit të murit. Mund të kemi të bëjmë me një nivel ecjeje. Trashësia nuk mund të verifikohet.

#### **Faza AT 2**

Gjatë kësaj faze duket se janë ndërtuar dy mure (8044 dhe 8052), që duhet të ishin mbetje të dy pilastrave (Fig. 14). Muri 8044 ndjek një orientim përgjithësisht lindje-perëndim dhe ishte 1,20 m i gjatë dhe 0,60 m i gjerë; u arrit të ndiqej deri në thellësinë 0,90 m (Fig. 15). Ishte punuar me gurë dhe tulla të lidhura me llaç. Prania në muraturë e disa gurëve të mëdhenj në nivelin e këndit tregon një fazë riparimi, ndoshta në kohën e ndërtimit të murit 8046 gjatë fazës 3.

Fig. 14: vendndodhja e mureve të antikitetit të vonë (RAFAD).

Fig. 15: pamje e ballinës veriore të murit 8044 (RAFAD).

Muri 8052 ishte rreth 4 m në lindje të murit 8044 dhe ndiqte një orientim lindje-perëndim. Duket se ishte i zhvendosur paksa drejt veriut përkundrejt murit 8044. I ruajtur mbi 1,06 m në gjatësi dhe 0,66 m gjerësi, ai u arrit të ndiqej për mbi 1,24 m në thellësi (Fig. 16). Ai ishte punuar me gurë dhe tulla të alternuara, të lidhura me llaç. Këndi jugperëndimor i murit ishte dëmtuar gjatë germimit të gropës mesjetare 8095. Në fasadën veriore të murit ishin të pranishme dy zgavra afërsisht nga 0,15 m.

Fig. 16: detaj i murit 8046 (RAFAD).

#### **Faza AT 3**

Përgjatë kësaj faze, muraturës ekzistuese duket se i janë bërë disa ndryshime, dëshmuar nga prania e katër mureve (8046, 8051, 8096, 8066) dhe nga gjurmët e një muri të grabitur (8067). Muret 8051 dhe 8096 ishin të ndërlidhur mes tyre, duke formuar një kënd; muri 8046 ishte mbështetur tek muri 8044 me të cilin formonte edhe një kënd (Fig. 12). Muri 8046 kishte orientim jug-veri dhe ndiqej mbi 0,60 m në gjatësi, 0,60 m gjerësi. Më pak i ruajtur se muri 8044, me lartësi të zbuluar 0,75 m (Fig. 17). Ishte punuar me gurë dhe tulla të lidhura me llaç. Muri 8051 ishte mbështetur te muri 8044 dhe lidhej me të me llaç; ndiqte të njëjtin orientim perëndim-lindje si muri i mëparshëm (Fig. 17). Ai kishte një gjatësi prej 0,90 m me një gjerësi prej 0,60 m dhe një lartësi të vëzhguar prej 1,38 m. Ishte punuar me gurë dhe tulla të alternuara të lidhura me llaç. Përmasat e tullave ishin identike me ato të murit 8046. Muri 8096 ndiqte orientimin jug-veri. I ruajtur dhe niveluar shumë keq, u zbulua në rreth 0,30 m gjatësi, gjerësi 0,60 m, lartësi e ruajtur 0,35 m. Ishte punuar nga gurë dhe tulla të alternuara, të lidhura me llaç me përmasa identike me ato të murit 8051. Muri 8066 ishte mbështetur tek muri 8052 dhe lidhej me të me llaç. Ndiqte të njëjtin orientim perëndim-lindje si ky i fundit. Ishte prerë në pjesën lindore nga gropa mesjetare 8068. Ruhej në një gjatësi prej 0,64 m dhe gjerësi 0,62 m për një lartësi të vëzhguar 1,17 m (Fig. 18). Ishte punuar me tulla dhe gurë të alternuar, të lidhur me llaç. Faqja veriore ishte punuar vetëm nga gurë gëlqerorë. Grabitja murit 8067 ishte qartësisht e dukshme në pjesën perëndimore të murit 8052. Zona ishte dëmtuar shumë nga gërmimi i disa gropave mesjetare, që kufizonte njohjen e situatës. Ndoshta bëhet fjalë për një muraturë të vogël, me shumë mundësi e ndërtuar me vetëm një rresht tullash, duke mbyllur të paktën një pjesë të hapësirës midis mureve 8052 dhe 8051.

Fig. 17: pamje e ballinës veriore të murit 8051 (RAFAD).

Fig. 18: pamje e ballinës veriore të murit 8066 (RAFAD).

#### **Faza AT 4**

Muri 8064 ndjek një orientim juglindje-veriperëndim dhe duket paksa jashtë aksi përkundrejt mureve të tjerë (Fig. 14). Ai ishte prekur shumë nga gërmimi i disa gropave mesjetare, gjë që i vështirësonte vëzhgimet (Fig. 19). Ai u ndoq përafërsisht 1 m në gjatësi dhe kishte një gjerësi prej 0,60 m për një lartësi të vëzhguar prej 1,10 m. I ndërtuar kryesisht nga tulla të lidhura me llaç, qëndron në pjesën perëndimore të murit 8052, në vend të njësisë së grabitur 8067. Bashkë me murin 8052 formonte një kënd rreth 75-80°.

Fig. 19: pamje e dëmtimeve të murit 8064 (RAFAD).

#### **Faza AT 5**

Gjatë kësaj faze ishte formuar një shtresë braktisjeje (US 8086) dhe disa varre ishin mbështetur tek muret. Shtresa e braktisjes 8086 u gërmua për një trashësi rreth 0,40 m, por nuk

u arrit fundi. Përbëhej nga rërë argjilore me ngjyrë kafe të errët, me përmbajtje fragmentesh tjegullash, tullash, kockash kafshësh dhe fragmente qeramike. Në këtë shtresë gjendeshin varret 8084, 8085 dhe 8087. Varri 8084 ndodhej në një hapësirë të vogël, të formuar nga muret 8044, 8046, 8051 dhe 8096 (Fig. 20). Me gjasë bëhet fjalë për një varr fëmije duke pasur parasysh përmasat (0,70 x 0,25 m, thellësia e gërmuar 0,40 m)<sup>29</sup>. Bëhet fjalë për një varr me mbulesë tjegullash me çati dyujëse (Fig. 21), i orientuar lindje-perëndim, që nuk u arrit të gërmohej.

Fig. 20: pamje e varrit 8084 midis mureve të ndryshme (RAFAD).

Fig. 21: pamje e varrit 8084 nga lindja (RAFAD).

Varri 8085 gjendej pranë seksionit jugor. Ishte i dëmtuar rëndë dhe kishin mbetur vetëm disa fragmente tjegullash dhe pak kocka të një fëmije, përmasat e të cilave sugjerojnë për një moshë në vdekje rreth 2 vjeç.

Varri 8087 u identifikua në hapësirën ndërmjet mureve 8051 dhe 8064. Gjendej shumë i dëmtuar nga ndërhyrjet e mëvonshme mesjetare, dhe si pasojë ruhej vetëm një fragment i madh tjegulle si dhe disa fragmente të tjera të shpërndara (Fig. 22).

Fig. 22: pamje e mbetjeve të varrit 8087 (RAFAD).

### ***Periudha mesjetare***

Kësaj periudhe i përkasin 23 njësi. Ato gjendeshin mes thellësive 1,60 m dhe më shumë se 3,20 m. Analiza e tyre bëri të mundur përcaktimin e 3 fazave të quajtura Med 1 deri në Med 3.

#### **Faza Med 1**

Kjo fazë përkon me ndërtimin e një muri (8049) dhe formimin e disa shtresave braktisjeje (8041, 8042 dhe 8062) dhe rrënimi (8047, 8055, 8063 dhe 8065). Muri 8049 ndodhej në pjesën lindore të sondazhit (Fig. 23), me orientim lindje-perëndim. Gjatësia e gërmuar ishte 2,70 m, gjerësia 0,50 m, lartësia e ruajtur 0,40 m. Ishte ndërtuar me tulla, tjegulla, blloqe gëlqerore dhe gur ranor, me rreshta të çrregullt. Llaçi lidhës ishte i përzier me fragmente të vogla tjegullash dhe tullash. Në prerjen lindore u identifikua kanali i themelit, i cili ishte dëmtuar përgjatë gërmimit të gropës 8068.

Fig. 23: pamje e përgjithshme e mureve mesjetare (RAFAD).

---

<sup>29</sup> Varri nuk mund të gërmohej për shkak të paqëndrueshmërisë së faqes jugore të sondazhit.

Shtresa e braktisjes 8062 ndodhej në pjesën jugore të sondazhit dhe mbulonte varret e fëmijëve. Përbëhej nga një shtresë argjilore me ngjyrë të gjelbër, me trashësi rreth 0,10 m, që përmbante fragmente tjegullash dhe gurësh.

Shtresat e braktisjes 8041 dhe 8042 ishin të pranishme në të dyja anët e mureve 8044 dhe 8051. Shtresa 8041 gjendej në jug dhe mbulonte mbetjet e murit 8046; shtresa 8042 në krahun verior. Për këtë arsye mendojmë se bëhet fjalë për të njëjtën shtresë, e cila kishte trashësi rreth 0,20 m, e përbërë nga argjilë ranore gri në të zezë, më përmbajtje karboni, fragmente qeramike, tullash, tjegulla dhe gurë. Në këndin e formuar nga muret 8044 dhe 8046, krijohej gjithashtu edhe një depozitë rrënimi (8065), e përbërë nga një grumbull tullash dhe gurësh që ndoshta vijnë nga muret. Tre grumbullime të ngjashme (8047, 8055 dhe 8063) u identifikuan në anën tjetër të mureve, në pjesën veriore (Fig. 24).

Fig. 24: pamje e nivelit të rrënimit 8063 (RAFAD).

## **Faza Med 2**

Kjo fazë përkon me ndërtimin e një muri (8050), ndoshta në të njëjtën kohë si edhe një nivel ecjeje (8040), një shtresë mbushjeje (8057), si dhe gërmimin e të paktën 4 gropave (8050, 8061, 8070 dhe 8095). Muri 8050 ndjek një orientim verilindje/jugperëndim (Fig. 23), ishte ngritur mbi murin 8049. Ishte i cunguar në të dy skajet dhe u gërmua në një gjatësi prej 2,15 m, gjerësi 0,70 m, i ruajtur deri në lartësinë 0,48 m. Ndërtohej me 3 breza gurësh gëlqerorë të mëdhenj (afërsisht 0,40 x 0,30 m), të kombinuar me gurë më të vegjël dhe të lidhur me llaç (trashësia mesatare 0,03 m). Duke qenë se në pjesën verilindore nuk ishte mbështetur më mbi murin më të hershëm, por mbi një shtresë mbetjesh ndërtimore - 8057 (rreth 0,40 m trashësi, i përbërë nga gurë, fragmente tjegullash, llaçi dhe rëre), ka pësuar një ulje prej disa dhjetëra centimetrash (Fig. 25). Ndoshta kemi të bëjmë me një shtresë mbushjeje të sjellë përpara ndërtimit të murit.

Niveli i ecjes 8040 u vu re në pjesën jugore të gërmimit, në kontakt me murin 8050, ku mbulonte shtresat e fazës së mëparshme. Me trashësi 0,20-0,25 m, ai përbëhej nga rërë ngjyrë gri, me përmbajtje fragmentesh gurësh, tjegullash, llaçi, qermike, qymyr druri dhe kocka kafshësh.

Tre gropa u gjetën pranë njëra-tjetrës, të cilat kishin dëmtuar murin 8064 (Fig. 26). Gropa 8060 gjendej mes mureve 8052 dhe 8064 të cilat i kishte prerë, si dhe futej brenda njësisë 8041. Në formë pak a shumë rrethore (0,40 m në diametër), zbriste në një thellësi rreth 0,30 m para se të ndalej tek muri 8064. Ishte e mbushur me argjilë ranore kafe në të zezë, e përzier me fragmente tullash, thëngjijshe dhe qeramike (8059).

Fig. 25: pamje seksionale e zonës së shembjes së murit 8050 (RAFAD).

Fig. 26: vendndodhja në plan e gropave 8060, 8061 dhe 8095 (RAFAD).

Gropa 8061 ndodhet në veri të murit 8064, në afërsi të murit 8052 dhe priste njësinë 8042. Në formë pak a shumë rrethore (diametër 0,60 m), ajo shfaqet qartazi falë gjurmës gjysmërrethore të mbetur në murin 8064. Ndjekur deri në thellësinë afro 0,50 m, ishte e mbushur me argjilë jeshile, përzier me fragmente gëlqerore, tullash dhe qeramike (8058).

Gropa 8095 priste fasadën perëndimore të murit 8064 dhe njësinë 8041. Në formë pak a shumë rrethore (diametër 0,50 m), ajo shfaqet gjithashtu dukshëm falë gjurmës gjysmërrethore të lënë në murin 8064. Ishte e mbushur me rërë argjilore në ngjyrë të zezë, që përmbante fragmente qeramike, tullash dhe llaçi (8094). Duke qenë se njësohet me shtresën 8041 u arrit të ndiqej për afro 0,20 m, që përkon me gjurmën e lënë në muraturë.

Gropa e fundit (8070) u vërejt në prerjen jugore. Gërmimi duket se fillonte nën shtresën 8040 dhe priste shtresat 8062 dhe 8086. Kishte një gjerësi mesatare 0,60 m, për një thellësi të vlerësuar më shumë se 0,60 m (duke qenë se nuk arritëm dot fundin e saj). Mbushja (8071) përbëhet nga rërë kafe në të zezë, me përzierje fragmentesh tullash, guri dhe llaçi.

### **Faza Med 3**

Kjo fazë përfaqësohet vetëm nga një gërmim i madh i vërejtur në pjesën lindore të gërmimit (8068; Fig. 27). Kjo gropë, përmasat e së cilës nuk mund të përcaktohen saktë, shfaqet 1,60 m nën nivelin aktual dhe përshkonte të gjitha njësitë deri në më shumë se 3,20 m thellësi. Prekeshin prej saj muri mesjetar 8049, muri i antikitetit të vonë 8066 dhe ai antik 8077. Gropa ishte e mbushur me rërë argjilore në ngjyrë të zezë me shumë mbetje të karbonizuar druri, fragmente tullash, tjegulla, gurë, qeramikë dhe kocka kafshësh (8069). Në nivelin pranë murit antik përbërja e saj ndryshonte paksa, me shfaqjen e gjurmëve të oksidimit, të fragmenteve qeramike të djegura, si dhe një rritje të vëllimit të qymyrit të drurit (8080).

Fig. 27: pamje e përgjithshme e mureve moderne (RAFAD).

### ***Periudha moderne***

Kësaj periudhe i përkasin 23 njësi (Fig. 28-31). Ato gjendeshin mes thellësive 0,90 deri në 2,60 m. Analiza e tyre bëri të mundur përcaktimin e 4 fazave (Mod 1-Mod 4).

Në fazën e parë ishte ndërtuar një mur (8073) dhe janë krijuar dy nivele ecjeje (8035 dhe 8037), si dhe dy shtresa braktisjeje ose mbushjeje (8036 dhe 8039). Faza e dytë duket se përbëhet nga vetëm një shtresë braktisjeje (8090), e vëzhgueshme vetëm në pjesën

veriperëndimore të gëimit, e pranishme në të dyja anët e nivelimit të murit 8073 dhe që mbulon nivelin e ecjes 8037.

Në fazën e tretë ishte ndërtuar muri 8026, ndoshta i lidhur me një nivel të mundshëm ecjeje (8043). Ky mur përshkonte gërimin në të gjithë gjatësinë e tij duke ndjekur një orientim veriperëndim-juglindje (Fig. 27). Gjatësia e zbuluar ishte 8,10 m, lartësia e ruajtur 1,32 m, dhe ishte prerë në pjesën lindore e dëmtuar në pjesën perëndimore nga ndërtimet bashkëkohore. Muri ngushtohet në pjesën e sipërme, duke pasur gjerësi 1,08 m në themel, dhe 0.85 m në pjesën e sipërme të murit të ruajtur. Themeli ishte punuar me blloqe guri gëlqeror të vendosura pa rregull, të lidhur me llaç. Ndërsa muri (për aq sa ruhej), ishte ndërtuar duke përdorur një përzierje gurësh dhe tullash të lidhura me llaç. Në sipërfaqen e murit dukeshin dy hulliza paralele (8027 dhe 8028) me gjerësi 0,10 m dhe thellësi 0,08 m (Fig. 30). Një hendek themeli relativisht i ngushtë (0,10 m) u vu re në veri (8025). Një nivel ecjeje (8043) u vu re në afërsi të faqes veriore të murit. Vende-vende mbulonte shtresën mbushëse të hendekut të themelit 8038.

Faza finale përfaqësohet nga një sërë nivelesh braktisjesh, mbushjesh dhe prishjesh. U gërmuan tre shtresa rrërimi për këtë fazë, por vetëm njëra duket se lidhet drejtpërdrejt me çmontimin e murit 8026 (njësia 8024), të tjerat duket se janë vendosur më vonë (njësitë 8033 dhe 8082).

Fig. 28: pamje e murit 8073 dhe pragut 8074 (RAFAD).

Fig. 29: detaj i njësisë 8037 (RAFAD).

Fig. 30: detajet e kanaleve 8027 dhe 8028 (RAFAD).

### ***Periudha bashkëkohore***

Kësaj periudhe i përkasin 27 njësi (Fig. 31). Ato ndodhen ndërmjet sipërfaqes aktuale dhe thellësisë 1,80 m. Analiza e tyre bëri të mundur përcaktimin e 5 fazave të funksionimit. Përgjatë fazës së parë ishte krijuar një shtresë e trashë mbushjeje (8012), e vërejtur pothuajse në të gjithë sipërfaqen e sondazhit. Në fazën pasuese ishte ndërtuar një ngrehinë, prej së cilës ruheshin mbetjet e themeleve punuar me beton dhe gurë (8018, kanali i ngushtë i themelit 8017). Faza e tretë karakterizohej nga shumë ndërhyrje, të lidhura me krijimin e një ndërtese dhe infrastrukturën e saj sipërfaqësore dhe nëntokësore. Përgjatë fazës së pestë ka pasur ndërhyrje sistemimi territori dhe përmirësimi të rrjetit të kanalizimeve. Në fazën e fundit ekzistonte vetëm një shtresë rrënojash nga prishja e ndërtesave të vjetra (8001).

Fig. 31: pamje e këndit veriperëndimor të gëimit me pllaka 8002 dhe 8083 në sipërfaqe (RAFAD).

## STUDIME GJEORKEOLOGJIKE: BREGDETI, LAGUNA DHE PORTI

Porti antik i Dyrrachiumit ishte nyje trafiku intensiv, siç dëshmohet nga materiali i zbuluar në forum. Identifikimi i këtij porti përbën një element shumë të rëndësishëm për historinë e qytetit. Studiues të ndryshëm e kanë vendosur në pozicione të ndryshme: vendndodhja e tij tradicionale është konsideruar përgjithësisht nën portin mesjetar dhe modern, në juglindje të qytetit. Një tjetër propozim e vendos në veri të portit modern<sup>30</sup>. Megjithatë, një hipotezë tjetër propozon vendosjen e tij në skajin jugor të qytetit<sup>31</sup>. Në përpjekje për të shtuar njohuritë tona mbi evolucionin gjeomorfologjik të qytetit, menduam të nevojshme krijimin e një programi studimor mbi gjeologjinë dhe morfologjinë e tij, mbi bazën e parimit se vendndodhja e portit mund të përcaktohet, ose në çdo rast të rivlerësohet, duke marrë parasysh parasysh këta faktorë të ndryshëm të cilët duhet të lidhen me të dhënat e siguruar nga arkeologjia.

Gjithsej janë kryer 21 karotazhe, në dy faza (Fig. 32), brenda në qytetin e Durrësit, por edhe në rrethinat, me synimin për të kuptuar evolucionin e bregdetit dhe lagunës, për të rindërtuar gjeografinë e gadishullit ku vendosej Epidamnus-Dyrrachium gjatë antikitetit, por edhe në përpjekje për të lokalizuar vendndodhjen e portit. Një fushatë e parë përnjohëse u krye në dhjetor 2021 (9 karotazhe prej 10 metra thellësi secila) për të përcaktuar karakteristikat e përgjithshme të zonës lagunore e cila ishte e pranishme, deri në shek. XX, midis Durrësit dhe prapatokës. Një fushatë e dytë prej 11 karotazhesh u zhvillua paralelisht me gërmimet në forum, në maj-qershor 2022, për të sqaruar rindërtimin paleogjeografik. Rezultatet e marra janë të jashtëzakonshme, edhe pse për momentin ato janë ende në trajtë hipotezash duke qënë se jemi në pritje të përgjigjeve nga të gjitha datimet absolute (14C dhe Liquid Scintillation Counting). Me përgjigjet e mara nga pesë prej analizave datuese të marra deri tani (Fig. 34), po nisim të vërtetohen hipotezat. Rindërtimi paleogjeografik, bazohet kryesisht në studimin sedimentologjik të karotazheve të kryera.

Pikat ku janë kryer karotazhet shtrihen përgjatë tre profileve me drejtim veri-jug, duke përshkuar zonën e ish-lagunës nga njëra anë në tjetrën, nga veriu në jug (Fig. 32). Zona bregdetare rreth Epidamn-Dyrrachiumit ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme që nga antikiteti. Për këtë arsye ishte e rëndësishme kryerja e këtij studimi gjeorkeologjik për të kuptuar kufizimet hapësinore të cilat kanë ndikuar në organizimin e planit urbanistik. Dy aspektet kryesore të këtij evolucioni paleogjeografik janë, nga njëra anë evolucioni i pozicionit të bregdetit dhe, nga ana tjetër, luhatjet e hapësirës së lagunës që zinte pjesën fushore në lindje

<sup>30</sup> Propozim nga Adrian Anastasi.

<sup>31</sup> SHEHI 2020, f. 64 (periudha helenistike).



të qytetit. Pozicioni i bregut dhe shtrirja e lagunës kanë përcaktuar pozicionimin e mëtejshëm të rrugëve hyrëse dhe ujësjellësit, vendndodhjen e pellgut portual dhe hapësirën në dispozicion që mund të përdorej për zhvillimin urban. Njohja e mjedisit në të cilin shtrihet qyteti bën të mundur që të kuptohet më mirë edhe zhvillimi i tij. Për më tepër, ky rindërtim na lejon të kuptojmë më qartë përdorimin e strukturave të zbuluara në të kaluarën në pjesën fushore, në periferi të qytetit (faltoret antike, varreza periudhës romake, fortifikimet e antikitetit të vonë në Portës/Porto Romano).

Para se të kryhej kjo fushatë studimore, njohuritë mbi evolucionin e fushës së Durrësit ishin të kufizuara, kryesisht disa studime gjeologjike dhe pak qasje arkeologjike. Po kështu, këto studime ishin të pakoordinuara me njëra-tjetrën.<sup>32</sup> Hartat dhe fotografitë e shek. XIX-XX tregojnë se fusha ishte e mbuluar nga një lagunë e gjërë, e hapur kryesisht drejt detit në veriperëndim (nga vendkalimi i Portës/Porto Romanos) (Fig. 32), ku dallgët e së cilit përplaseshin në istmin ranor jugor të lagunës, në afërsi të qytetit të Durrësit (Fig. 33). Në mesin e shek. XX laguna u kthye në një kanal gjarpërues, që të çonte në Portës/Porto Romano. Ajo u bonifikua në vitet 1960 dhe u shndërrua në një zonë bujqësore. Nga vitet 1990 gjysma jugore e lagunës, duke përfshirë dhe istmin jugor të saj, ranë pre e urbanizimit të pakontrolluar. Ndërtimi i një porti të ri tregtar në Potës/Porto Romano, përbën shndërrimin e të gjithë pjesës veriore të lagunës brenda një periudhe afatshkurtër në një zonë industriale-portuale. Në këtë kontekst, karotazhet kanë qëllim gjithashtu krijimin e arkivave sedimentare, përpara se sektorë të tërë të fushës të mos jenë më të aksesueshëm për kërkimin akademik.

Fig. 32: vendndodhja e bërthamave dhe elementeve paleogjeografike të identifikuara gjatë fushatës së karotazheve (RAFAD).

Fig. 33: shtrirja e lagunës në fillim të shekullit të 20-të.

Rindërtimi i lagunës, mbi bazën e këtyre karotazheve (Fig. 34) së shpejti do të mbështetet nga rreth pesëmbëdhjetë datime me radiokarbon mbi mbetjet e bimëve tokësore dhe ujore. Analiza paraprake e *facieve* sedimentare nga karotazhet e kryera, si edhe pesë datimet tashmë të disponueshme bëjnë të mundur hartimin e një skeme fillestare të evolucionit paleogjeografik lokal (Fig. 35). Faktet më të spikatura janë si më poshtë.

Fig. 34: përshkrim stratigrafik paraprak i 21 karotazheve të kryera me vendndodhjen e mostrave 14C dhe vendgjetjet qeramike (RAFAD).

Fig. 35: profili gjeologjik veri-jug përgjatë fushës së Durrësit, bazuar në stratigrafinë e 21 karotazheve (RAFAD).

---

<sup>32</sup> Mbi nivelin e studimeve në këto fusha shiko SHEHI 2023, f. 17-52, 516-545.

### ***Përballë qytetit: një ish-gji detar i qetë***

Aspektet moderne dhe prania e lagunës në verilindje të qendrës së qytetit, deri në periferi të vetë qytetit, na shtynë të mendojmë se bonifikimi i kënetës përfaqëson fazën përfundimtare të mbushjes së një lagune të pranishme që nga prehistoria, e lundrueshme, thellësia e së cilës është reduktuar për shkak të sedimentimit. Karotazhet e realizuara në fushë, pranë gjurmëve të vjetra, tregojnë se strukturat e gjermuara, si « Altari i Kënetës », ujësjellësi si dhe parcelat funerare të periudhës romake, janë vendosur drejtpërdrejt mbi brezat ranor më të hershëm të istmit jugor. Këta breza nisën të dilnin në sipërfaqe gjatë antikitetit. Ky istëm është mbuluar nga depozitimi rërave të cilat formuan breza të njëpasnjëshëm, të mbivendosur ndaj njëri-tjetrit, nga veriu në jug, në një gjatësi prej të paktën 3 kilometra. Drejtimi i këtyre brezave mund të shpjegojë drejtimin e veçantë të ujësjellësit romak, i cili nuk është përherë linear. Në një trakt të tij, ka një kthesë e cila ndjek pikërisht formën e brezave. Datimet në proces do të na mundësojnë të përcaktojmë pozicionin e bregut gjatë periudhës romake, për të cilin, mendojmë se ka qënë pranë ujësjellësit, 1,7 km larg nga bregu aktual. Në këtë formë, qyteti ka qënë i zhvilluar përgjatë istmit jugor që shtrihej drejt lindjes. Ky istëm ka qënë shumë më i gjerë se ai i ditëve të sotme. Ai përbëhet nga rëra, fraksioni i të cilave nga lindja duke shkuar drejt perëndimit, luhet nga mesatare në të imëta (lymet detare të karotazheve DYR-6, 10 dhe 21), ç'ka tregon një reduktim të madh të energjisë dallgëzuese drejt qytetit. Porti i qytetit ndoshta mund të jetë zhvilluar përballë kontinentit, në një hapësirë shumë të mbrojtur, nën strehën e zinxhirit shkëmbor të Durrësit. Datimi i kampionit të marrë në thellësinë 2,71 m në karotazhin DYR-6 (Fig. 34) na tregon se rreth viteve 400-600 m.Kr. nuk ka pasur mundësi ankorimi në këtë zonë, por bregdeti nuk duhej të gjendej larg. Datimi i kampionit të marrë në thellësinë 7,55 m në karotazhin DYR-10 konfirmon praninë e detit të thellë në periudhën romake dhe më tej në jug. Me fjalë të tjera, asnjë *tombolo* nuk u formua në këtë sektor para një periudhe shumë të vonë, pas shek. X m.Kr.

### ***Zhvillimi i lagunës pas brezave të rërës***

Brezat ranorë, pas depozitimit të tyre në brendësi të territorit për shkak të grumbullimit të brezave të rinj, u përmytën nga laguna e Durrësit. Kjo lagunë u zhvillua fillimisht rreth vitit 4500 p.Kr., në gjysmë të rrugës nga brigjet aktuale, midis bërthamave DYR-8 dhe DYR-9, ndoshta kur niveli i detit, pasi ishte rritur me 120 m gjatë 10 mijëvjeçarëve të mëparshëm, ishte 5-6 m në nivelin aktual. Rritja e nivelit të detit më pas izoloi kodrat e Durrësit nga kontinenti dhe një krah i detit mbuloi gjithë fushën e Durrësit. Rërat nga deti dhe nga lumi Erzen formuan brezat e parë të rërës midis ishullit të Durrësit dhe kontinentit. Më pas filloi të krijohet laguna

e Durrësit, midis istmit verior dhe atij jugor. Shtimi gradual i brezave të rinj ranorë në veri dhe në jug u shoqërua me ngritjen e lartësisë së kreshtës së tyre, e cila shoqëronte rritjen e ngadalhtë të nivelit të detit. Ky fenomen çoi në zhytjen e brezave të parë në ujërat e lagunës, e cila nisi të zgjerohej gradualisht drejt veriut dhe jugut. Sektori i “Altarit” dhe i ujësjellësit, të ndërtuar gjatë periudhës helenistike dhe romake, në një periudhë më të vonë u përmytën nga ujërat e lagunës, deri në mesin e shek. XX. Në fushën e Durrësit, krahas fenomenit të rritjes së nivelit të detit i shtohet edhe zhytja tektonike. Zona bregdetare shqiptare paraqet një varg rrudhash pozitive dhe negative të pranëthyerjeve, të formuara nga antiklinale dhe sinklinale të mbihipura. Sinklinalet u fundosën dhe u mbuluan me fusha të zhytura, si p.sh. fusha e Durrësit e cila gradualisht u mbulua me sedimente detare, lagunore dhe lumore. Antiklinalet gjatë procesit të ngritjes, formuan zinxhirë kodrinorë, si p.sh. brezi kodrinor i Durrësit. Antiklinalet shpesh u mbivendosen sinklinaleve. Rasti më i dukshëm është mbihipja e krahut lindor të antiklinalit të Durrësit mbi sinklinalin e Fushës së Durrësit (çarja tektonike e Lushnjes, Fig. 32).

### ***Portës/Porto Romano: një hapje e vonë e lagunës drejt perëndimit***

E vendosur në veriperëndim të lagunës, kalimi i Portës/Porto Romanos ishte ende grykëderdhja kryesore e lagunës në det në shek. XX. Prania e fortifikimeve bizantine në jug të këtij kalimi sugjeron se kontrolli i saj kishte një rëndësi strategjike, pasi ishte një pikë alternative aksesi në portin e Dyrrachiumit nga veriu, duke kaluar përmes lagunës. Kalimi i Portës/Porto Romanos kufizohet në të dy skajet nga kodra shkëmbore, përkatësisht Kepi i Palit në veri dhe kodrat e Durrësit në jug (Fig. 32). Këto kodra, të përbëra nga shkëmbinj të thërrmueshëm, po gërryhen me shpejtësi. Është shumë e mundshme që konfigurimi gjeografik i shtegut të kalimit të ketë ndryshuar ndjeshëm që nga antikiteti, dëshmuar nga prania e gjurmëve të strukturave të lashta në tabanin detar në sektorin pranë Portës/Porto Romano si dhe vendbanimet neolitike në proces erozioni në Kepin e Palit. Pozicionimi i brezave ranorë përgjatë bregut verior dhe prania e depozitimeve lagunore nën zhavorrite dhe rërave të plazhit aktual çojnë në përfundimin se ky shteg nuk ka qënë i pranishëm përgjatë shumicës së kohës së ekzistencës së lagunës. Karotazhet në këtë sektor janë kryer për të përcaktuar periudhën e krijimit të shtegut, si pasojë e erozionit të shkëmbinjve mes Kepit të Palit dhe kodrave të Durrësit dhe për të përcaktuar gjerësinë e tij në periudhën romake. Analiza e kampionit të marrë në thellësinë 2,75 m në karotazhin DYR-16 e daton shtresën në vitet 3500-3100 p.Kr., duke nënkuptuar se brezi ranor që i mbron ata vetëm në veri është të paktën po aq i hershëm. Prandaj, ne mund të vërejmë një kontrast të dukshëm midis përparimit shumë të kufizuar të brezave të

rërës në veri në 5000 vjet (350 m) dhe përparimit të tyre në jug (1700 m në 2000-2500 vjet), i cili, në të vërtetë, është kryer në një mjedis më të qetë, në fund të një gjiri të mbrojtur.

### *Një korridor lagunor në periferi të qytetit*

Elementi më spektakolar dhe më enigmatik i zbuluar gjatë këtyre fushatave të karotazheve është prania e një korridori lagunor i cili shtrihet me drejtim veri-jug përgjatë krahut lindor të kodrave të Durrësit, deri në zemër të qytetit antik. Ky korridor është përpindikular me drejtimin e brezave ranorë të Gjirit të Durrësit. Prania e strallevave të rënë në nivelet argjilore të karotazheve të Portës/Porto Romanos sugjeron shfrytëzimin e këtij korridori që nga periudha neolitike. Duke iu afruar Durrësit, në shtresat argjilore, fragmentet qeramike janë të shumta në 5-7 m thellësi dhe tregojnë përdorimin e korridorit të lagunës për një periudhë të gjatë kohore. Prania sistematike e argjilave në karotazhet DYR-2, 5, 19 dhe 20 sugjeron që ky korridor lagunor arrinte deri në veri të qendrës së qytetit, pas skajit jugor bregdetar. Prania e tij sugjeron se porti i Dyrrachiumit gëzonte jo vetëm hyrje në gjirin e Durrësit në pikën e tij më të qetë, por edhe hyrje në lagunë nga veriu, e kështu edhe në det nëpërmjet shtegut në Portës/Porto Romano. Ky korridor lagunor bënte të mundur edhe mbrojtjen e qytetit nga sulmet e papritura nëpërmjet tokës. Muret e trasha mbrojtëse të gërmuara në vendin e «Altarit të Kënetës»<sup>33</sup>, mund të shihen në këtë kontekst si tregues i një pararoje mbrojtëse, drejt kontinentit, të zonës së kalimit nga drejtimi i lagunës.<sup>34</sup>

Datimi i radiokarbonit në proces dhe analizat e qeramikës së gjetur në karotazhe do të bëjnë të mundur përcaktimin e moshës relative të argjilave që mbushin këtë krah lagunor (karotazhet DYR-2, 5, 9, 19, 20) dhe të sedimenteve detare që kanë mbushur në afërsi Gjirin e Durrësit (karotazhet DYR-3, 14, 6,10,21). Këto datime do të na bëjnë të mundur të mësojmë nëse argjilat janë të depozituara në një shteg, të hapura mbi breza ranorë të dalë mbi ujë, ose nëse ato janë depozituar, në të njëjtën kohë me rërat detare në një basen portual të ndarë nga gjiri detar prej veprave të mbrojtjes artificiale.

Një aspekt enigmatik i këtij zbulimi është trashësia e serisë argjilore, e cila i kalon dhjetë metrat në karotazhet më të afërta me kodrat e Durrësit. Një trashësi e tillë është shumë më e madhe se modelet e varkave antike, çka sugjeron se ky korridor lagunor është të paktën pjesërisht me origjinë natyrore. Paraqitja e saj, pingul me brezat ranorë, ngre shumë pyetje. Mund të jetë një kalim i vjetër, që ka lejuar evakuimin e ujërave të lumit Erzen, nëse ai derdhej

<sup>33</sup> MYRTO 1989, f. 87-104 dhe veçanërisht f. 89, fig. 2.

<sup>34</sup> Ideja se muri në fjalë ka shërbyer si strukturë mbrojtëse, shprehur nga ABADIE-REYNAL*et alii.* 2018c, f. 294; SHEHI 2017, f. 86.

në lagunë, përpara hapjes së shtegut të Portës/Porto Romanos, ose një kalim i prodhuar nga vërshimi i ujërave të lagunës kur frynin erërat veriperëndimore. Pozicioni i saj, përgjatë rrëzës së kodrave të Durrësit, në rrëzë të çarjes tektonike të Lushnjës, na shtyn të marrim në konsideratë edhe kontributin e zhytjes tektonike në krijimin apo mirëmbajtjen, të paktën përkohësisht, të këtij korridori lagunor.

## PËRFUNDIME

Në fund të kësaj fushate të rëndësishme kërkimore kushtuar portit të Dyrrachiumit, mund të propozohen disa hamendësime dhe një proces evolucionari i peizazhit detar, që do t'i nënshtrohen shqyrtimit të të dhënave kronologjike dhe analizave sedimentologjike në muajt në vijim.

Kështu, duket se korridori i thellë i lagunës që ndan ishullin origjinal të Dyrrachiumit nga kontinenti në lindje, ofronte një vend shumë të mbrojtur, mjaftueshëm të gjerë sa të mund të përdorej si port përgjatë një hapësire kohore të antikitetit, në çdo rast deri në periudhën romake. Prania e objekteve të shumta në karotazhet DYR 1, 2, 20, por edhe DYR 9 në Portës/Porto Romano, tregon se i gjithë ky korridor ka qenë shumë i frekuentuar përgjatë antikitetit. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e mbetjeve arkeologjike antike në vendndodhjen e këtij korridori, si dhe thellësia e konsiderueshme në të cilën ndodhen objektet e fragmentuara, sugjerojnë se e gjithë kjo hapësirë ishte lënë e lirë për qarkullim. Prandaj, baseni i portit mund të hamendësohet se ndoshta gjendej në verilindje të qytetit, nga Lulishtja 1 Maji, ose edhe më në veri, deri në Portës/Porto Romano. Kjo vendosje, ndër të tjera, do të bënte të mundur kuptimin e paraqitjes së dy hyrjeve të ngushta të përshkruara nga Cezari (*BC 3.58*)<sup>35</sup>. Është ende e nevojshme të kontrollohet nëse të gjitha këto fragmente të gjetura në thellësi, nuk janë rezultat i erozionit nga brezi kodrinor. Në këtë drejtim ndihmesë do të jenë analizat sedimentologjike. Nuk mund të thuhet ende nëse dhe si mund të lidhen disa mbetje strukturash prej druri të zbuluara në gërmimet e Lulishtes 1 Majit<sup>36</sup> me këtë hamendësim që po shtrojmë. Ndoshta edhe muri i fuqishëm i zbuluar në perëndim të “Altarit të Kënetës” mund të konsiderohet si një tregues i një mbrojtjeje pararojë, në drejtim të kontinentit, në zonën e kalimit në krahun e lagunës.

Në fund të shek. I m.Kr. ose në fillim të shek. II, mund të perceptohen modifikime të rëndësishme në funksionimin e mundshëm të portit dhe qytetit. Nga njëra anë, është momenti

---

<sup>35</sup> « *Caesar quo facilius equitatum Pompeianum ad Dyrrachium contineret et pabulatione prohiberet aditus duos, quos esse angustos demonstravimus, magnis operibus praemunit castellaque hic locis posuit* », në anglisht “In order to make it easier to confine Pompey’s cavalry at Dyrrachium and prevent it from foraging, Caesar sealed off the two approaches (which were narrow, as I indicated) with substantial earthworks, establishing strongholds there.”

<sup>36</sup> FRASHËRI 2015, f. 139-146.

kur lidhja me kontinentin në lindje materializohet nga ndërtimi i ujësjellësit. Kjo është edhe koha kur krijohen parcela funerare në vendndodhjen e korridorit të lagunës<sup>37</sup>. Të gjithë këto elementë tregojnë se komunikimi me rrugë detare mes Portës/Porto Romanos dhe pjesës jugore të qytetit është ndërprerë. Padyshim që do të jetë e nevojshme të kuptohet pas cilit fenomen ka pasur mbushje të pjesshme të korridorit të lagunës: a mund të jetë një tërmet, apo shira të rrëmbyeshëm në origjinë të këtij evolucioni? Edhe këtu analiza sedimentologjike të korridorit lagunor (karotazhi DYR 2) do të mund të na sigurojë të dhëna të reja. Pra, ku gjendej porti në periudhën romake? A funksiononte ai veçmas, në veri dhe në jug të këtij brezi ranor? A funksiononte ende vetëm pjesa veriore e aksesuar nga Portësa/Porto Romano? Studimi i gjetjeve në karotazhe dhe kronologjia e tyre do të na japë informacionin e nevojshëm. Në çdo rast, shek. I ose fillimi i shek. II m.Kr. është gjithashtu koha kur urbanistika e Dyrrachiumit pëson ndryshime të thella me krijimin e akseve të mëdha rrugore të orientuara veri-jug,<sup>38</sup> ndërsa orientimet e vjetra të rrugëve, verilindje/jugperëndim, ruhen brenda insulave. A synonte ky zhvillim urbanistik të lehtësonte komunikimin me veriun e qytetit dhe pellgjet portuale të cilat tani mund të kufizohen në këtë pjesë të qytetit?

Së fundi, një fazë e tretë, përgjatë antikitetit, duket se mund të shquhet në këtë evolucion të portit. Në shek. V m.Kr. dhe me ndërtimin e mureve të qytetit, ndoshta dukej e nevojshme të mbroheshin basenet portuale nëpërmjet fortifikimeve, në juglindje të qytetit. Apo ka qenë përparimi i mbushjes së gjirit jugor ai që detyroi portin të zhvendosej në jug? Mundet që të ketë qenë kjo një nga arsytet e evolucionit urban, përgjatë së cilës lagjia rezidenciale e vendosur nën forum zëvendësohet nga kjo ndërtesë e përkushtuar mbi të gjitha për tregtinë dhe tani e vendosur pranë pellgjeve portuale ashtu si hapësira e kishës së Shën Luçisë, e cila më pas ka përjetuar një dendësi të lartë ndërtimesh.

## **Bibliografia**

CESAR, *Civil War*. C. Damon, (ed.), Loeb Classical Library 39, Cambridge: Harvard University press, 2016.

ABADIE-REYNAL *ET AL.* 2018a : C. ABADIE-REYNAL, E. SHEHI, B. SHKODRA, A. LEFEBVRE, K. VELO, Recherches archéologiques franco-albanaïses de Dyrrachium. Résultats de la campagne de 2018, *Dialogue Histoire Ancienne* 44.2, 2018, f. 320-333.

---

<sup>37</sup> TARTARI 2004, sektori C, f. 11, 39 (varre të datuar në shek. I-II m.Kr.).

<sup>38</sup> Shiko për shembull ABADIE-REYNAL *et alii.* 2018b, f. 182-184.

- ABADIE-REYNAL *et alii*. 2018b : ABADIE-REYNAL, A. LEFEBVRE, E. SHEHI, B. SHKODRA-RRUGIA, Topografia e Epidamne-Dyrrachion. Fushata e vitit 2017, *Candavia* 7, 2018, f. 175-206.
- ABADIE-REYNAL *et alii*. 2018c : C. ABADIE-REYNAL, E. SHEHI, B. SHKODRA, Y. MANON, Recherches sur la topographie de Durrës, në J-L. LAMBOLEY, L. PËRZHITA, A. SKËNDERAJ (eds.), *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'antiquité VI (Conference, Tirana, mai 2015)*, Tirana 2018, f. 291-299.
- ABADIE-REYNAL *et alii*. 2019 : C. ABADIE-REYNAL, E. SHEHI, B. SHKODRA, K. VELO Recherches archéologiques franco-albanaises de Dyrrachium. Résultats de la campagne de 2018, *Dialogue Histoire Ancienne* 45.2, 2019, f. 335-404.
- CLÉMENT *et alii*. 2022 : B. CLÉMENT, B. BLONDEL, G. CHARPENTIER, D. BALDASSARI, La place du bois dans la colonie romaine de Vienne. L'exemple du 'complexe commercial A-B' à Sainte-Colombe, *Pallas* [Në linjë], 110 | 2019.
- FOY 2015 : D. FOY, Les marques sur les récipients en verre découverts en Gaule : indices de production et de relations commerciales (milieu Ier s.-Ve s. ap. J.-C.), *Gallia* 72.2, 2015, 351-401.
- LAFORGE 2009 : M.-O. LAFORGE, *Chapitre premier. Les lieux de culte à Pompéi*, në *La religion privée à Pompéi*. Naples : Publications du Centre Jean Bérard, 2009.
- FUCHS 2016 : M. FUCHS, Témoignages du culte domestique en Suisse romaine, në F. FONTANA, dhe E. MURGIA (eds.), *Sacrum Facere, Atti del III Seminario di Archeologia del Sacro. Lo spazio del "sacro" : ambienti e gesti del rito, Trieste, 3-4 ottobre 2014*, 2016, f. 106-107 (maison du Génie domestique, Martigny).
- MARANGOU-LERAT 1996 : A. MARANGOU-LERAT, *Le Vin et les Amphores de Crète de l'époque classique à l'époque impériale*, *Études crétoises* 30, 1996.
- SHEHI 2017 : E. SHEHI, Rishikim mbi topografinë e Durrësit antik në dritën e të dhënave të reja arkeologjiko-historike, *Iliria* 41, 2017, f. 71-131.
- SHEHI 2019 : E. SHEHI, Review of the ancient and late antique fortifications of Epidamnos-Dyrrachion, në L. M. CALIÒ G. M. GEROGIANNIS, M. KOPSACHEILI (eds.), *Fortificazioni e società nel Mediterraneo occidentale. Albania e Grecia settentrionale. Atti del Convegno di Archeologia, organizzato dell'Università di Catania, dal Politecnico di Bari e dalla University of Manchester, Catania-Siracusa, 14-16 febbraio 2019*, 2020, 175-190.
- SHEHI 2023: E. SHEHI, *Topografia e Durrësit Mesjetar*, Tiranë 2023 [në botim].
- MYRTO 1989 : H. MYRTO, Një sanktuar antik në periferi të Durrësit, *Iliria* 1, 1989, 87-108.

FRASHËRI 2015 : G. FRASHËRI, *Illyrisches Dyrrah. I. Die Grabung Lulishtja 1 Maj*, Tiranë 2015.

TARTARI 2004 : F. TARTARI, *La nécropole du Ier-IVe s. de notre ère à Dyrrachium*, Durrës 2004.